



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:911472
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05520555

C.nr.1015/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditësit R.N nga P, i përfaqësuar në bazë të autorizimit nga "A.M" sh.p.k, me seli në P, kundër të paditurve: 1) K.S "S", me seli në P, e përfaqësuar nga R.R - zyrtar ligjor dhe 2) N "A.T " sh.p.k, me seli në P, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve "S & Q" sh.p.k, me seli në P, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 23,580.30 €, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik të dt.20.03.2024, në prezencën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, av. B.S, përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës së parë, R.R, si dhe përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës së dytë, av. B.A, me datë 26.03.2024 mori, ndërsa me datë 28.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësit R.N nga P ndaj të paditurës së parë K.S "S" me seli në P, ashtu që: DETYROHET e paditura e lartëcekur, që paditësit, në emër të kompensimit të dëmit material si pasojë e aksidentit të pësuar në vendin e punës me dt.16.12.2011, t'ia paguajë shumat si në vijim:

-Në emër të dëmit material:

-Për ndihmën dhe kujdesin e huaj, shumën prej.....250,00 €
-Për ushqim të përforcuar, shumën prej.....270,00 €
-Për shpenzimet e mjekimit, shumën prej.....180,30 €

II. DETYROHET e paditura e parë K.S "S" me seli në P, që paditësit R.N, shumat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë së bashku me normën e kamatës e cila vlen si për mjetet e depozituara në bankat afariste që operojnë në Republikës e Kosovës, në afat më tepër se një vit, pa destinim të caktuar, duke e llogaritur nga data e ushtrimit të padisë në Gjykatë, dt.25.09.2012, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. REFUZOHET E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit R.N nga P, ndaj të paditurës së parë K.S "S", me seli në P, përtej shumave të gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë: në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, në shumën prej 50.00 €, si dhe në emër të ushqimit të përforcuar, në shumën prej 30.00 €. Po, ashtu, refuzohet në tërësi si e pa bazuar pjesa

e kërkesëpadiisë së paditësit ndaj të paditurës së parë K.S "S", me seli në P, dhe atë: në emër të dëmit material – për rehabilitim fiziko - terapeutik në shumën prej 800.00 €, si dhe në emër të dëmit jo material: për dhimbjet fizike, në shumën prej 6,000 €; për frikën e përjetuar, në shumën prej 5,000 €; për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në shumën prej 6,000 € dhe për shëmtim trupor, në shumën prej 5,000 €.

IV. REFUZOHET NË TËRËSI kërkesëpadiia e paditësit R.N nga P, kundër të paditurës së dytë N "A.T " sh.p.k, me seli në P, SI E PA BAZUAR.

V. DETYROHET e paditura e parë K.S "S", me seli në P, që paditësit R.N, në emër të shpenzimeve të krijuara në këtë procedurë kontestimore t'ia paguajë shumën e përgjithshme në vlerë prej 93.36 € (nëntëdhjetë e tre euro e tridhjetë e gjashtë cent), ndërsa DETYROHET paditësi R.N, që të paditurës së dytë, N "A.T", me seli në P, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguajë shumën e përgjithshme në vlerë prej 1,019.20 € (një mijë e nëntëmbëdhjetë euro e njëzet cent), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

- Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Paditësi R.N nga P, përmes përfaqësuesit të autorizuar, N.M, avokat në P, fillimisht me datë 25.09.2012, pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë, kishte parashtruar padi kundër të paditurës K.S "S", me seli në P, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material, lëndë kjo e cila është evidentuar nën shenjën C.nr.2528/12. Në padi ndër tjera pretendohet se paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë vullnetare për sigurim personal për periudhën kohore 28.03.2011 - 28.03.2012. Tutje është theksuar se paditësi gjatë një operacioni në vendin e punës dhe gjatë orarit të punës, me datë 16.12.2011, ka pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përjetshme, si pasojë e të cilave ka pësuar dhimbje trupore, ka përjetuar frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shëmtim trupor, ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë, ushqim të përforcuar, rehabilitim klimaterik dhe janë krijuar shpenzime rreth shërimit. Më tej ka theksuar se në bazë të kontratës për sigurimin vullnetar, e paditura ka marrë përsipër tërë rrezikun që mund t'i ndodhë paditësit gjatë periudhës 28.03.2011 - 28.03.2012, andaj mbi këtë bazë, pas aksidentit të dt.16.12.2011, i është drejtuar me kërkesë të veçantë për kompensimin e dëmit material dhe jo material, por e paditura nuk ka qenë korrekte në konstatimin e natyrës së lëndimeve të pësuar si dhe në shumën e ofruara për kompensim, të cilat pala paditëse i ka konsideruar si jo ekuivalente në raport me dëmin e pësuar.

Në seancën përgaditore të mbajtur me datë 06.07.2017, paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka bërë zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv, duke e përfshirë në cilësinë e palës së paditur edhe N "A.T" sh.p.k, me seli në P, me arsyetim se me kontratën vullnetare që është lidhur në mes të punëtorëve të kësaj të fundit dhe K.S "S", janë përcaktuar shumën fikse për kompensimin e dëmit dhe shumën e përcaktuara në këtë kontratë nuk janë ekuivalente me pasojat e pësuar për paditësin. Gjykata në seancën përgaditore të mbajtur me datë 21.09.2017, duke vepruar sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, e ka lejuar zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv edhe në raport me të paditurën N "A.T", me seli në P, krahas të paditurës së parë, K.S "S", me seli në P.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes aktgjykimit C.nr.2528/12, të dt.06.02.2018, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit R.N nga P, në raport me të paditurën e parë K.S "S", me seli në P, ndërsa e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit në raport me të paditurën e dytë N "A.T", me seli në P.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar sipas ankesave të parashtruara nga përfaqësuesit e autorizuar të të paditurve, përmes aktvendimit Ac.nr.1642/18, të dt.14.02.2022, e ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil C.nr.2528/12, të dt.06.02.2018, duke e kthyer lëndën në rigjykim dhe rivendosje.

Në riprocedim, kjo Gjykatë fillimisht ka caktuar dhe ka mbajtur seancën përgaditore me dt.13.11.2023, me ç'rast në kuptim të dispozitës së nenit 409 par.1 të LPK-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit. Duke vepruar sipas propozimit për kthim në gjendje të mëparshme dhe ankesës ndaj këtij aktvendimi, të parashtruara nga i autorizuari i paditësit, përmes aktvendimit të dt.22.12.2023, në kuptim të dispozitës së nenit 129 par.1 dhe 2, lidhur me nenin 186 par.3 të LPK-së, e ka aprovuar propozimin për kthim në gjendje të mëparshme, e ka prishur aktvendimin e lartëcekur me të cilin është konsideruar e tërhequr padia dhe çështja është kthyer në gjendjen në të cilën ndodhej para marrjes së aktvendimit, si dhe e ka hedhur poshtë si të palejueshme ankesën e palës paditëse.

Gjykata e shkallës së parë, në kuptim të vërejtjeve dhe sugjerimeve nga aktvendimi i lartëcekur i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1642/18, i dt.14.02.2022, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor me dt.20.03.2024, në të cilën kanë prezantuar i autorizuari i paditësit, av. B.S, i autorizuari i të paditurës së parë, R.R dhe i autorizuari i të paditurës së dytë, av. B.A.

Në seancën gjyqësore, ashtu edhe në fjalën përfundimtare, të deponuar në formë të shkruar, i autorizuari i paditësit, av. B.S, ndër tjera ka theksuar se mbetet në tërësi pranë pretendimeve të theksuara në procedurën paraprake, duke shtuar se sa i përket vërejtjeve të konstatuara në aktvendimin e Gjykatës së Apelit, në bazë të provave të administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar, rrjedh obligimi i të paditurve që paditësit t'ia kompensojnë dëmin e pësuar në vendin e punës me datë 16.12.2011, dhe atë nga baza e kontratës për sigurimin shëndetësor si dhe nga baza e përgjegjësisë objektive - pa faj. Tutje ka theksuar se paditësi është lënduar në vendin e punës, siç është konstatuar edhe me ekspertizën e mbrojtjes dhe sigurisë në punë të nxjerrë në procedurën C.nr.2528/12, të përpiluar nga ing. H.N. Më tej i është referuar edhe ekspertizës mjekësore të dt.07.12.2017, duke shtuar se ndaj ekspertizave të lartëcekura palët nuk kanë paraqitur vërejtje, duke konsideruar se nga këto prova është vërtetuar mjaftueshëm baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë, andaj nuk ka parashtruar ndonjë propozim për nxjerrjen e provave të reja. Në seancën përgaditore, i autorizuari i paditësit e ka bërë edhe precizimin e lartësisë së kërkesëpadisë, duke e dorëzuar precizimin në formën e parashtrësës, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohen të paditurat K.S "S", me seli në P dhe N "A.T", me seli në P, që paditësit, në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material nga lëndimi në vendin e punës me dt.16.12.2011, t'ia paguajnë shumat si në vijim: për dëmin jo - material: në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 6,000 €; në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 5,000 €; në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 6,000 €; në emër të shëmtimit trupor shumën prej 5,000 €; për dëmin material: në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 300.00 €; në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 300.00 €; në emër të

rehabilitimit fiziko-terapeutik, shumë prej 800.00 €; në emër të shpenzimeve të shërimit shumë prej 180.30 €, të gjitha këto me kamatë në lartësi prej 8%, duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim. Shumat e lartëcekura i ka konsideruar reale dhe që ofrojnë një kompensim të arsyeshëm për dëmin e pësuar për paditësin, qoftë atë jo material, ashtu edhe atë material. Në raport me pretendimin e të paditurës së dytë N "A.T", lidhur me parashkrimin e kërkesës, një pretendim të tillë e ka konsideruar të papranueshëm dhe në kundërshtim me gjendjen faktike të konstatuar në këtë procedurë, duke e pohuar faktin se zgjerimi i padisë në raport me këtë të paditur është bërë me dt.29.09.2017, mirëpo pas marrjes së përgjigjes në padi, është vënë në dijeni lidhur me faktin se kontrata e sigurimit nuk i përfshinë të gjitha kategoritë e dëmit, andaj menjëherë pas vënies në dijeni lidhur me këtë rrethanë, e ka bërë zgjerimin e padisë, rrethanë kjo e cila e vërteton faktin se nuk ka ekzistuar qëndrimi pasiv i paditësit për realizimin e kërkesës.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, të specifikuar në parashtrësën e dorëzuar në seancën e dt.20.03.2024, në shumë e përgjithshme prej 1,556.00 €, dhe atë: për përpilimin e padisë në shumë prej 104.00 €; për 4 seanca të mbajtura në procedurën C.nr.2528/12, shumë prej 540.80 €; për ekspertizë nga lëmia e sigurisë në punë, shumë prej 150.00 €; për ekspertizë mjekësore shumë prej 200.00 €; për taksë për padi shumë prej 60.00 €, si dhe shpenzimet e krijuara në riprocedurë dhe atë: për një seancë të mbajtur shumë prej 202.80 €; për një seancë të shtyrë shumë prej 101.40 €; si dhe për precizimin e padisë shumë prej 156.00 €.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës së parë, K.S "S", me seli në P, në seancën e dt.20.03.2024, ashtu edhe në fjalën përfundimtare të deponuar në formë të shkruar, ndër tjera ka theksuar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve nga seanca e kaluar, duke e kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit sa i përket bazës dhe lartësisë së saj, duke i propozuar Gjykatës që të veprojë sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, duke e sqaruar llojin e kontratës së sigurimit dhe çfarë kategorie të dëmit mbulon kjo policë e sigurimit. Më tej ka theksuar se e paditura edhe më tej i qëndron ofertës së dhënë në procedurë administrative në shumë prej 680.00 €, shumë kjo e cila është bazuar në kontratën e sigurimit dhe mbulueshmërinë e saj, e që është e gatshme ta ofrojë edhe sot. Sa i përket precizimit të lartësisë së kërkesëpadisë nga ana e të autorizuarit të paditësit, përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës së parë e ka kundërshtuar mbi bazën e pretendimit se shumat e kërkuara nuk janë të bazuara në policën e sigurimit dhe të njëjtat janë tepër të larta. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës së dytë, N "A.T", në seancën e dt.20.03.2024, ashtu edhe në fjalën përfundimtare të deponuar në formë të shkruar, ndër tjera ka deklaruar se në këtë rast kemi të bëjmë me një pretendim të paditësit i cili sipas deklarimeve të të njëjtit ka lindur me datë 16.12.2011. Lidhur me këtë pretendim ka inicuar padi, mirëpo vetëm ndaj të paditurës së parë, ndërsa në zhvillim e sipër të procesit gjyqësor, konkretisht në procesverbalin e datës 21.09.2017, është bërë zgjerimi subjektiv i padisë, ku në procedurë është përfshirë edhe e paditura e dytë. Tutje ka theksuar se lidhur me kërkesën e parashtruar ndaj kësaj të paditure është shfaqur instituti i parashkrimit objektiv, pasi që kërkesa është paraqitur më shumë se 5 vite pas aksidentit. Mbi bazën e një pretendimi të tillë, i ka propozuar gjykatës që sa i përket të paditurës së dytë të merr aktgjykim refuzues për shkak të parashkrimit. Më tej ka theksuar se meqë Gjykata e Apelit nuk ka dhënë ndonjë sugjerim për ekspertizë apo prova tjera që do të kërkonin seanca të reja, i ka propozuar Gjykatës që të kalohet në shqyrtim kryesor, administrim të provave dhe fjalë përfundimtare. Sa i përket precizimit të lartësisë

së kërkesëpadisë nga ana e të autorizuarit të paditësit, bazuar në deklaratimet e mëhershme e ka kundërshtuar edhe këtë precizim.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, të specifikuar në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar në shumën e përgjithshme prej 1,465.20 €, duke iu referuar Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës në kontestet e vlerës mbi 10.000 €, dhe atë: për përpilimin e përgjigjes në padi në shumë prej 208.00 €; për ankesë ndaj aktgjykimit në shumë prej 208.00 €; për taksë për ankesë në shumën prej 30.00 €; për përgjigje në ankesë në shumë prej 208.00 €, si dhe për 3 seanca të mbajtura në shumë prej 811.20 €.

- Gjendja faktike e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në riprocedim, në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.20.03.2024, gjatë procedurës së administrimit të provave, meqenëse nuk janë parashtruar propozime për nxjerrjen e ndonjë prove të re, ka administruar provat materiale nga procesverbali i seancës së shqyrtimit kryesor i evidentuar nën shenjën C.nr.2528/12, i dt.06.02.2018, dhe atë:

Fletëparaqitja e aksidentit personal në vendin e punës e dt.16.12.2011, e përpiluar nga e paditura e dytë; Raporti i QKUK-së - Qendra Emergjente nr..., i dt.16.12.2011, së bashku me dokumentacionin mjekësor; Polica e sigurimit për aksidentet personale me numër ..., për periudhën kohore 28.03.2011-28.03.2012; Kontrata nr..., e lidhur me dt.28.03.2011; Kontrata e punës për paditësin e dt.01.01.2011; Vërtetimi i lëshuar nga e paditura e dytë i dt.18.07.2017; E-maili i të paditurës së dytë i dt.30.05.2012; Ekspertiza mjekësore e përpiluar nga Dr. B.Q - Ortoped - traumatolog dhe Dr. S.B - Psikiatre e dt.07.12.2017; Ekspertiza nga lëmia e sigurisë në punë, e përpiluar nga Dr. Ing H.N, e muajit tetor të vitit 2017.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, me ç'rast ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në mes të palëve ndërgjyqëse, fillimisht nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi R.N ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën e dytë, N "A.T ", me seli në P, sipas kontratës së punës së nënshkruar me dt.01.01.2011. Sipas nenit 1 të kësaj kontrate, paditësi është caktuar në vendin e punës "... ", ndërsa në kuptim të nenit 2, kohëzgjatja e paraparë e kësaj kontrate ka konsistuar në periudhën prej 12 muajsh (nga data 01.01.2011, gjer me datën 31.12.2011), me mundësi vazhdimi sipas marrëveshjes.

Tutje, në mes të palëve ndërgjyqëse, po ashtu nuk rezulton të jetë kontestues fakti se me datën 16.12.2011, paditësi ka pësuar aksident në vendin e punës, fakt ky i cili fillimisht është konstatuar në bazë të fletëparaqitjes së aksidentit personal në vendin e punës të dt.16.12.2011, të përpiluar nga e paditura e dytë. Rrethanat e këtij aksidenti janë sqaruar në detaje në bazë të ekspertizës nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, e përpiluar nga Dr. Ing. H.N, në muajin tetor të vitit 2017, në kuadër të procedurës së mëhershme të evidentuar nën shenjën C.nr.2528/12. Sipas kësaj ekspertize janë dhënë konstatimet si në vijim:

"Punëdhënësi nuk ka ndërmarrë veprime të duhura për t'i përmbushë detyrimet lidhur me ndërmarrjen e masave të nevojshme për siguri dhe shëndet në punë përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave; trajnimeve, organizimit përkatës dhe masave të duhura; Nuk ka bërë kontrollimin paraprak/ para fillimit të punës dhe sistematik mjekësor; Nuk është bërë vlerësimi i rreziqshmërisë në vendin e punës; Nuk është njoftuar punëtori para fillimit të punës për rreziqet ndaj të cilave ai mund të ekspozohet; Nuk ka pasë udhëzime me shkrim se nuk guxon me e rregulluar kamionin e ngarkuar me zhavor, por përkundrazi është urdhëruar ta rregullojë kamionin pa e zbrazur; Nuk ka pasë përshkrim të të gjitha detyrave të punës, ku figuron nënshkrimi i punëtorit; Nuk është prezantuar provë se ka organizuar trajnimin nga lëmia e sigurisë në punë, ku në regjistër figuron nënshkrimi i punëtorit, modulet dhe data e mbajtjes së trajnimit, emri dhe mbiemri i trajnuesit dhe certifikata e lëshuar në emër të punëtorit; Nuk ka prezantuar kartelën e pajisjeve personale mbrojtëse me të cilat ka qenë i ngarkuar paditësi; Paditësi ka bërë një lëshim të vogël që ka pranuar rregullimin e prishjes së kamionit, duke e ditur se rimorkio është në ngarkesë të plotë".

Mendimi dhe vlerësimi përfundimtar i ekspertit përkatës ka konsistuar në faktin se punëdhënësi ka qenë i detyruar të zbatojë masat parandaluese, duke mos e rregulluar këputjen e federit të rimorkios së kamionit, përderisa ka qenë në gjendje të ngarkuar me peshë të plotë, andaj mban përgjegjësinë bazuar në detyrimet dhe parimet e përgjithshme me ligjin që ka qenë në fuqi kur ka ndodhur lëndimi, në kuptim të dispozitës së nenit 2.2 të Ligjit Nr.2003/19 për Sigurinë në Punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, në kuptim të dispozitave nga nenet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 42 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212.

Meqenëse palët ndërgjyqëse në riprocedim nuk e kanë kontestuar ekspertizën e lartëcekur e as nuk kanë propozuar nxjerrjen e ndonjë prove të re, e në anën tjetër Gjykata e Apelit në aktvendimin me të cilin e ka kthyer çështjen në rigjykim dhe rivendosje nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje apo sugjerim në drejtim të të gjeturave të kësaj ekspertize, Gjykata ia fali besimin e plotë në funksion të sqarimit të rrethanave të aksidentit që paraqet objekt shqyrtimi në këtë çështje kontestimore.

Si pasojë e aksidentit të përshkruar më sipër, paditësi i është nënshtruar tretmanit të menjëhershëm mjekësor, fakt ky i cili vërtetohet në bazë të raportit të QKUK-së - Qendra Emergjente nr..., të dt.16.12.2011, së bashku me dokumentacionin mjekësor mbështetës të bashkangjitur në shkresat e lëndës. Me qëllim të vërtetimit të natyrës dhe shkallës së lëndimeve të pësuar, në procedurën e mëparshme është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizës mjekësore, me ekspertë nga lëmia e ortopedisë - traumatologjisë, respektivisht e psikiatrisë, me ç'rast për ekspertë janë caktuar: Dr. B.Q - Otroped - Traumatolog dhe Dr. S.B - Psikiatër.

Ekspertët e lartëcekur kanë dhënë mendimin dhe konstatimin e tyre me shkrim me dt.07.12.2017. Në mendimin e dhënë, ekspertët fillimisht kanë konstatuar se pas ekzaminimit klinik të drejtpërdrejtë të paditësit dhe shqyrtimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, i njëjti ka pësuar këto lëndime trupore: "*Dg: Amputatio partialis phalangae distalis pollicis mani dex - Amputim parcial i falangës distale të gishtit të madh të dorës së djathtë*", lëndim ky i cili konsiderohet si lëndim i natyrës së rëndë trupore.

Në raport me dhimbjet fizike, ekspertët përkatës kanë konstatuar se paditësi nga momenti i shkakimit të aksidentit e deri në dhënien e ndihmës së parë ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë për 30 minuta; dhimbje të intensitetit të rëndë për 24 orë, kohë pas kohe deri në marrjen e

terapisë kundër dhimbjeve; dhimbje të intensitetit të mesëm për 2 javë të tjera; dhimbje të intensitetit të ulët, sipas të dhënave nga bashkëbisedimi janë prezente edhe më tutje.

Në raport me frikën e përjetuar, është konstatuar se paditësi ka përjetuar frikë primare në momentin e aksidentit, e cila prezantohet si frikë nga vdekja dhe kërcënimi direkt për integritetin e tij fizik, e cila ka zgjatur disa sekonda; frikë sekondare të intensitetit të lartë, e cila ka zgjatur për 48 orë, e shoqëruar me ankth, shqetësim dhe simptoma përcjellëse të reagimit akut ndaj stresit; frikë sekondare të intensitetit të mesëm, e cila ka zgjatur për 3 muaj, e përcjellur me mungesë të disponimit, probleme me gjumin, lodhje në angazhimet minimale, mungesë iniciative dhe rënie të aktivitetit, mungesë koncentrimi dhe motivimi, rikujtim të ngjarjes traumatike si dhe ankesa të shumta somatike; frikë sekondare të intensitetit të ulët, që ka vazhduar edhe për dy muaj dhe është prezente edhe tani, e manifestuar me simptomat e lartëshënuara.

Tutje në mendimin dhe konstatimin e dhënë, ekspertët përkatës kanë konstatuar se paditësi ka pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 5%, ekziston shëmtimi trupor i shkallës së mesme për shkak të plagës prerëse të amputimit parcial të gishtit të madh të dorës së djathtë.

Ushqimi i përforcuar sipas ekspertëve ka qenë i nevojshëm për 4 javë, dhe atë ushqim i pasur me proteina, minerale, vitamina më shumë se sa ushqimi i zakonshëm. Ndiqja dhe kujdesi nga personi tjetër ka qenë i nevojshëm edhe për 4 javë, ndihmë në veshmbathje, higjenë etj, ndërsa rehabilitimi klimaterik dhe psikofizik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 30 ditësh brenda vitit të parë pas aksidentit.

Ngjashëm sikurse me ekspertizën nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, meqenëse palët ndërgjyqëse në riprocedim nuk e kanë kontestuar ekspertizën e lartëcekur e as nuk kanë propozuar nxjerrjen e ndonjë prove të re, e në anën tjetër Gjykata e Apelit në aktvendimin me të cilin e ka kthyer çështjen në rigjykim dhe rivendosje nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje apo sugjerim në drejtim të të gjeturave të kësaj ekspertizë, Gjykata ia fali besimin e plotë në funksion të sqarimit të formave të dëmit të pësuar për paditësin si pasojë e aksidentit në vendin e punës.

Fakt vendimtar për tu vërtetuar në këtë çështje kontestimore, bazuar edhe në pikëpamjet dhe udhëzimet e parashtruara përmes aktvendimit të Gjykatës së Apelit, konsiston në sqarimin e legjitimitetit pasiv të palëve të paditura, gjegjësisht çështjes se cila prej të paditurave e ka për detyrim ta kompensojë paditësin për dëmet e pësuar, respektivisht për cilat kategori dhe forma të dëmit dhe mbi cilën bazë, atë që rrjedhë nga kontrata për sigurim shëndetësor apo të përgjegjësisë objektive - pa faj.

Rrethanë tjetër për tu vërtetuar në këtë çështje kontestimore, e cila ka ardhur në shprehje në riprocedim, konsiston në vlerësimin e faktit nëse ka ardhur në shprehje parashkrimi i kërkesës së palës paditëse për kompensimin e dëmit jo material dhe material në raport me të paditurën e dytë, N "A.T", që njëherit paraqet pretendimin kyç të kësaj të fundit.

Nga polica e sigurimit për aksidentet personale me numër ..., për periudhën kohore 28.03.2011-28.03.2012, pjesë përbërëse e së cilës janë edhe kushtet e përgjithshme, vërtetohet fakti se përmes kësaj police e paditura e dytë ka siguruar 129 punëtorë të saj pranë të paditurës së parë për periudhën respektive (në mesin e të cilëve edhe këtu paditësin R.N, fakt ky i pa kontestueshëm mes palëve

ndërgjyqëse). Në pikën 4 të kësaj police janë specifikuar rastet të cilat mbulohen me këtë policë, e ku përfshihen: 1) Vdekja aksidentale; 2) Paaftësia totale e përhershme nga aksidenti; 3) Paaftësia totale e përkohshme nga aksidenti; 4) Shpenzimet mjekësore - hospitalizimi si rezultat i një aksidenti; 5) Kompensimi ditor; 6) Vdekja natyrore dhe 7) Evakuimi - riatdhesimi.

Nga kontrata nr..., e lidhur me dt.28.03.2011, në mes të të paditurës së parë, K.S "S", me seli në P, në cilësinë e siguruesit dhe të paditurës së dytë, N "A.T" sh.p.k, me seli në P, në cilësinë e të siguruarit, vërtetohet fakti se objekt i kësaj marrëveshje është dakordimi i palëve nënshkruese, që primi i shkruar në policën nr... të paguhet me këste. Më tej, sipas kësaj kontrate, i siguruari ka pranuar se polica e sigurimit për aksidente personale me nr..., me primin e shkruar në lartësi prej 4,889.10 €, është kontraktuar / blerë me nënshkrimin e tij, për interesa të tij, duke qenë i vetëdijshëm për të drejtat dhe obligimet ligjore që i përmbajnë kushtet e policës objekt i kësaj kontrate. Më tutje, siguruari ka pranuar se polica e sigurimit për aksidente personale nr..., me primin e shkruar në lartësi prej 4,889.10 €, është kontraktuar / shitur me nënshkrimin e tij si produkt i licencuar ligjërisht, duke qenë i vetëdijshëm për obligimin dhe të drejtat që i përmbajnë kushtet e policës, objekt i kësaj kontrate. Në nenin 2, palët janë dakorduar që primi i shkruar në policën objekt i kësaj kontrate në lartësi prej 4,889.10 €, është i pakontestueshëm, nga fakti se palët e kanë legjitimuar me nënshkrimin e tyre në policën e sigurimit nr..., të lëshuar me datë 28.03.2011.

Nga vërtetimi i lëshuar nga e paditura e dytë, me dt.18.07.2017, e njejta ka konstatuar se i punësuar i - këtu paditësi R.N me datë 16.12.2011 është lënduar në vendin e punës, ndërsa e padiura i ka mbuluar të gjitha shpenzimet mjekësore për trajtimin e mëtutjeshëm të të njejtit, duke shtuar se si kompani kanë pasur marrëveshje me të paditurën e parë për mbulueshmërinë e aksidenteve në punë të punëtorëve, me ç'rast ia kanë dërguar edhe gjithë dokumentacionin për kompensim.

Nga komunikimi elektronik përmes e-mailit mes të paditurës së parë dhe të dytë i dt.30.05.2012, vërtetohet fakti se e paditura e parë i është përgjigjur kërkesës për kompensimin e dëmit material dhe jo material të parashtruar pranë departamentit të dëmeve, për lëndimet e pësuar në aksidentin personal të punëtorëve të të paditurës së dytë (R.N dhe A.A), të cilët janë të mbuluar me policën e sigurimit, duke e njoftuar se komisioni për trajtimin e dëmeve ka bërë llogaritjen e dëmit në këtë mënyrë: Për të lënduarin - paditësin R.N, paaftësia totale e përhershme nga aksidenti është 5%, për 10.000.00 € të kontraktuar në bazë të policës së sigurimit nga aksidentet personale i takon kompensimi në vlerë prej 500.00 €. Më tej është theksuar se në emër të shpenzimeve mjekësore i takon kompensimi në shumën prej 180.30 €, ndërsa shuma në vlerë prej 208.00 € lidhur me shpenzimet për vajtje dhe ardhje nuk janë të kontraktuara në policën e sigurimit.

- Baza ligjore -

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të kërkesëpadisë së paraqitur, respektivisht pretendimeve të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, referuar natyrës dhe momentit kur është krijuar raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse, duhet t'i referohemi Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (tani e tutje LMD), të shpallur nga Kuvendi i RSFJ, në seancën e Dhomës Federative me datën 30 mars 1978, ligj ky i cili ka qenë në fuqi deri në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me dt.10.05.2012, i cili ligj ka hyrë në fuqi 6 muaj pas datës së publikimit.

Dispozita nga neni 154 e këtij ligji, e cila i referohet bazës së përgjegjësive për shkaktimin e dëmit përcakton që: *"Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmi për ambientin përgjigjet pavarësisht nga fajin. Për dëmin pavarësisht nga fajin përgjigjet edhe në raste të tjera të parashikuara me ligj"*. Dispozita e lartëcekur le të nënkuptohet se kemi të bëjmë me dy baza të përgjegjësive për shkaktimin e dëmit: 1) Përgjegjësia në bazë të fajit dhe 2) Përgjegjësia objektive - pa faj. Dispozita nga neni 155 e të njejtij ligj përcakton definicionin e dëmit dhe është e formuluar në këtë mënyrë: *"Dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar), si dhe shkak i tjetrit të dhimbjes ose të frikës fizike apo psikike (demi jomaterial)"*. Detyrimin për shpërblimin e dëmit material e definon dispozita e nenit 185 e këtij ligji, e cila parasheh që: *"Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundshme apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë dëmtuesit shumën përkatëse në të holla për efekt të kompensimit të dëmit. Gjykata do të gjykojë dëmtuesit kompensimin në të holla kur ai e kërkon këtë me përjashtim kur rrethanat e rastit konkrete justifikojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme"*. Në anën tjetër, çështja e shpërbimit të dëmit jo material përcaktohet me dispozitën e nenit 200 të LMD-së, e cila parasheh që: *"Për dhimbjet e pësuarat fizike, për dhimbjet e pësuarat shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror."*

Gjykata iu referua edhe nenit 897 të LMD-së, e cila përcakton nocionin e kontratës mbi sigurimin dhe është e formuluar në këtë mënyrë: *"Me kontratën mbi sigurimin obligohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit e të solidaritetit të bashkojë një shumë të caktuar në bashkësinë e sigurimeve respektivisht në bashkësinë e rrezikut (siguruesi), kurse bashkësia obligohet që nëse ndodhë ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t'i paguajë siguruesit apo ndonjë personit të tretë kompensimin, respektivisht shumën e kontraktuar që të kryejë diçka tjetër"*. Tutje, dispozita nga neni 898 e këtij ligji, e cila i referohet rastit të siguruar përcakton që: *"Ngjarja duke marrë parasysh se për cilën lidhet sigurimi (rasti i siguruar) duhet të jetë e ardhshme e pasigurtë dhe e pavarur nga dëshira ekskluzive e kontraktuesve"*. Neni 901 i këtij ligji përcakton që: *"Kontrata mbi sigurimin quhet e lidhur kur kontraktuesit nënshkruajnë policën e sigurimit ose e fletë-depozitën"*, ndërsa neni 902 përcakton: *"Në policë duhet të shkruhen palët kontraktuese, sendi i siguruar, respektivisht personi i siguruar, rreziku i përfshirë nga sigurimi, kohëzgjatja e sigurimit dhe periudha e depozitës, shuma e sigurimit ose se sigurimi është i pakufizuar, primia ose kontributi, data e dhënies së policës dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese"*.

Së fundmi, në funksion të vlerësimit të pretendimeve të të paditurës së dytë, N "A.T", lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, Gjykata iu referua dispozitës nga neni 360 të LMD-së, e cila

përcakton: "Me parashkrimin pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Gjykata nuk mund të përfillë parashkrimin në qoftë se debitori nuk e ka invokuar atë". Në anën tjetër, dispozita nga neni 376, e cila i referohet parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit përcakton që: "Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin. Sidoqoftë, kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi."

- Vlerësimi përfundimtar i Gjykatës –

- Pjesa e aprovuar e kërkesëpadisë -

Mbi bazën e provave të administruara më sipër, e në referim ndërlidhës me dispozitat ligjore të lartëcituara nga e drejta materiale, rrjedh se paditësi, si pasojë e aksidentit në vendin e punës të dt.16.12.2011, ka pësuar dëm jo material, (i cili konsiston në dhimbje fizike, frikë të përjetuar, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim), si dhe dëm material (i cili konsiston në nevojën për ushqim të përforcuar, ndihmë nga personi i tretë, shpenzime të shërimit). Kategoritë e lartëcekura të dëmit të pësuar, përfshirë edhe intentsitetin dhe kohëzgjatjen e tyre janë të specifikuara në ekspertizën mjekësore të dt.07.12.2017, të punuar nga Dr. B.Q - Otoped - Traumatolog dhe Dr. S.B - Psikiatër. Të gjeturat e kësaj ekspertize janë elaboruar në detaje në pjesën e mësipërme të arsyetimit të këtij aktgjykimi dhe këto të gjetura nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse në seancën e shqyrtimit kryesor. Se është fakt i pakontestueshëm që paditësit i takon e drejta për kompensim, është konstatuar edhe në faqen 4 të arsyetimit të aktvendimit të Gjykatës së Apelit, mirëpo ka ngelur të specifikohet baza e përgjegjësisë për kompensim për secilën kategori të dëmit nga palët e paditura.

Në rastin konkret, aksidenti në vendin e punës ka ndodhur me dt.16.12.2011, periudhë kohore kjo gjatë së cilës paditësi ka pasur mbulueshmëri të sigurimit nga aksidentet personale sipas kontratës nr.459, të dt.28.03.2011, respektivisht policës së sigurimit nr. 00459, të lidhur mes të paditurës së parë dhe të dytë, me kohëzgjatje për periudhën 28.03.2011 - 28.03.2012. Në këtë mënyrë, për të paditurën e parë, K.S "S", si palë siguroese në këtë kontratë, vjen në shprehje baza e përgjegjësisë kontraktuale për kompensimin e dëmit, në kuptim të dispozitës së lartëcekur nga neni 897, lidhur me nenin 154 të LMD-së, përkatësisht mbi bazën e këtyre dispozitave rrjedh obligimi i të njejtës për kompensimin e paditësit. Lidhur me faktin se cilat forma apo kategori të dëmit, e paditura e parë duhet të obligohet t'ia kompensojë paditësit, Gjykata i është referuar pikës IV të policës së sigurimit të specifikuar më lartë, nga e cila i rezulton se në kuadër të kategorive të dëmit për të cilat ofrohet mbulesë përfshihen shpenzimet e mjekimit dhe kompensimi ditor. Nga vështrimi i kushteve të përgjithshme, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj police, ku është dhënë interpretim më i gjerë, Gjykata vëren se në kuadër të shpenzimeve të mjekimit përfshihet si trajtimi spitalor, ashtu edhe ai ambulantor. Në këtë mënyrë, vlerësimi i Gjykatës konsiston në faktin se krahas shpenzimeve fikse të mjekimit në institucionet e kujdesit shëndetësor, edhe format e dëmit material ku përfshihen nevoja për ushqim të përforcuar dhe ndihmë nga personi i tretë duhet të përfshihen në kuadër të shpenzimeve të cilat janë në funksion të mjekimit të paditësit nga lëndimet e pësuar përmes trajtimit ambulantor, dhe si të tilla t'i nënshtrohen kompensimit.

Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në atë mënyrë që e detyroi të paditurën e parë që në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, t'ia paguajë paditësit shumë prej 250.00 Euro, marrë parasysh faktin se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar që paditësi si pasojë e dëmit të pësuar nga aksidenti ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj në kohëzgjatje prej 4 javësh pas aksidentit.

Sa i përket ushqimit të përforcuar, Gjykata e detyroi të paditurën e parë që t'ia paguajë paditësit shumë prej 270.00 Euro, duke marrë për bazë faktin se në bazë të ekspertizës mjekësore është konstatuar se ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 4 javë, dhe atë ushqim i pasur me proteina, minerale, vitamina më shumë se sa ushqimi i zakonshëm.

Gjykata sjellë në vëmendje faktin se për këto dy kategori të dëmit material (nevoja për ushqim të përforcuar dhe ndihma dhe kujdesi i huaj), ndonëse ka qenë e mundur që të argumentohet që kanë ardhur në shprehje me rastin e shkaktimit të dëmit, në praktikë është dukshëm e vështirësuar për tu argumentuar nga ana e paditësit lartësia e saktë e shpenzimeve të krijuara përmes prezantimit të provave materiale. Në këtë kuptim, është përcaktuar një standard që duhet vepruar në bazë të çmuarjes së lirë të Gjykatës, me rastin e vendosjes së një shpërblimi adekuat për këto lloje të dëmit, në mbështetje të dispozitës nga neni 323 të LPK-së, e cila përcakton që: *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tille do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë.”*

Lidhur me shpenzimet e shërimit, Gjykata e detyroi të paditurën e parë që t'ia paguajë paditësit shumë prej 180.30 Euro. Kjo për faktin se në bazë të provave materiale – faturave të cilat i janë bashkangjitur dokumentacionit mjekësor në shkresat e lëndës, vërtetohet fakti se për shërbimet e pranuar pranë Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës, paditësi ka paguar shumë e përgjithshme në vlerë prej 180.30 €, fakt ky i cili madje nuk është kontestuar nga e paditura.

Mbi këtë bazë, Gjykata në pikën I të dispozitivit e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke gjykuar shumat e specifikuar në këtë pikë të dispozitivit, me bindjen se në raport me dëmin material të pësuar, shumat e përcaktuara janë të nevojshme për ta kthyer gjendjen materiale të të dëmtuarit - këtu paditësit në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë para se të shkaktohej dëmi.

- Pjesa refuzuese e kërkesëpadisë -

Gjykata në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit ndaj të paditurës së parë K.S “S”, me seli në P, përtej shumave të gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, në shumë prej 50.00 €, si dhe në emër të ushqimit të përforcuar, në shumë prej 30.00 €. Kjo për faktin se çfarëdo shume e gjykuar përtej asaj që i është njohur paditësit në emër të kompensimit të këtyre formave të dëmit, nuk do të ishte në proporcion të plotë me intensitetin apo vëllimin e dëmit të pësuar dhe do ta tejkalonte qëllimin të cilit i shërben një shpërblim i tillë. Gjykata sjellë në vëmendje faktin se qëllimi i realizimit të kërkesës për kompensim nuk ka të bëjë me pasurimin e palës e cila e ka parashtruar kërkesën, por me kthimin e një gjendje e cila ka qenë para shkaktimit të dëmit, respektivisht ofrimin e një satisfakcioni moral për palën e dëmtuar në raport me të mirën e cënuar.

Në raport me pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kompensimin e dëmit material në emër të shpenzimeve lidhur me rehabilitimin fiziko – terapeutik, Gjykata mori në konsideratë faktin se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar se rehabilitimi klimaterik dhe psikofizik për paditësin ka qenë i nevojshëm për 30 ditë në vitin e parë pas aksidentit. Megjithatë, pala paditëse nuk ka prezantuar ndonjë provë materiale në drejtim të argumentimit të lartësisë së këtyre shpenzimeve, ndërsa vlerësimi i Gjykatës konsiston në faktin se shpenzimet e tilla, ndryshe nga ato që kanë të bëjnë me nevojën për ushqim të përforcuar dhe ndihmën dhe kujdesin e huaj, lehtësisht mund të argumentohen përmes provave konkrete materiale. Mbi këtë bazë, u refuzua në tërësi pjesa e kërkesëpadisë së paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të rehabilitimit klimaterik t'ia paguajë paditësit shumën prej 800.00 €.

Gjykata në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, po ashtu e refuzoi në tërësi si të pa bazuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit ndaj të paditurës së parë K.S "S", lidhur me kompensimin e dëmit jo material, dhe atë: për dhimbjet fizike, në shumën prej 6,000 €; për frikën e përjetuar, në shumën prej 5,000 €; për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në shumën prej 6,000 €, si dhe për shëmtim trupor, në shumën prej 5,000 €. Kjo bazuar në faktin se nga vështrimi në policën e sigurimit për aksidentet personale me numër ..., për periudhën kohore 28.03.2011 - 28.03.2012, specifikisht në pikën 4 të kësaj police, ku janë specifikuar kategoritë e dëmit të cilat mbulohen, nuk janë përfshirë edhe kategoritë e dëmit jo material, siç janë kompensimi në emër të dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar, zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor apo shëmtimi trupor. Një rrethanë e tillë është evidentuar edhe në arsyetim të aktvendimit të Gjykatës së Apelit (në faqet 4 dhe 5 të këtij aktvendimi). Mbi këtë bazë, në raport me këtë pjesë të kërkesëpadisë mungon përgjegjësia kontraktuale e të paditurës së parë, rrjedhimisht edhe baza lidhur me detyrimin e të njejtës për kompensimin e këtyre formave të dëmit në raport me palën paditëse.

Në raport me kërkesëpadinë e paditësit ndaj të paditurës së dytë, N "A.T " sh.p.k, Gjykata mori në konsideratë vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna përmes aktvendimit të Gjykatës së Apelit lidhur me sqarimin e bazës së përgjegjësisë së të paditurës në raport me kompensimin e dëmit ndaj paditësit. Në faqen 5 të këtij aktvendimi madje është vënë theksi tek fakti se e paditura e dytë, format e dëmit të cilat nuk janë të cekura në kontratën e sigurimit në mes të të paditurave, është e obliguar që t'ia kompensojë paditësit mbi bazën e përgjegjësisë objektive, për shkak të lëshimeve të konstatuara rreth sigurisë në vendin e punës në cilësinë e punëdhënësit, siç janë konstatuar në ekspertizën për sigurinë në punë të elaboruar më sipër. Në respekt të plotë lidhur me këto sugjerime, Gjykata e shkallës së parë sjellë vëmendjen tek një rrethanë e re, e paraqitur në ripoçedim të çështjes, e që ka të bëjë me pretendimin e të paditurës së dytë lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit në raport me këtë të paditur. Gjykata e trajtoi me vëmendje një pretendim të tillë në kuptim të dispozitës nga neni 360 të LMD-së, me ç'rast erdhi në këtë përfundim:

Në bazë të të gjitha provave të administruara në këtë çështje kontestimore, e në referim ndërlidhës me dispozitat e lartëcekura nga e drejta materiale, vlerësimi i Gjykatës konsiston në faktin se kërkesa e palës paditëse për kompensimin e dëmit jo material dhe material nga aksidenti i dt.16.12.2011, në raport me të paditurën e dytë N "A.T ", me seli në P, është e parashkruar. Në kuptim të dispozitës së lartëcekur nga neni 376 të LMD-së, kërkesat e tilla për kompensimin e dëmit parashkruhen në afat prej 3 vjetësh nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar këtë dëm (afat i natyrës subjektive). Në anën tjetër, kërkesa e tillë parashkruhet në afat prej 5 vjetësh nga data kur është krijuar dëmi (afat i natyrës objektive). Në rastin konkret, dëmi i pretenduar për paditësin

është shkaktuar me dt.16.12.2011, datë kjo kur ka ndodhur aksidenti në vendin e punës, ndërsa zgjerimi i padisë në aspektin subjektiv në raport edhe më të paditurën e dytë është parashtruar në seancën përgaditore të dt.06.07.2017, ndërsa është lejuar nga gjykata në procesverbalin e seancës së dt.21.09.2017, që njëherit paraqet datë kur është paraqitur kërkesa për kompensim në raport me këtë të paditur. Mbi këtë bazë, Gjykatës i rezulton se kërkesa e palës paditëse për kompensimin e dëmit, në raport me të paditurën e dytë është paraqitur pas kalimit të afatit prej 5 vitesh nga dita kur është shkaktuar dëmi. Gjykata mori në konsideratë pretendimin e të autorizuarit të paditësit lidhur me faktin se zgjerimi i padisë në raport me të paditurën e dytë është bërë me dt.29.09.2017, pas marrjes së përgjigjes në padi, me ç'rast është vënë në dijeni lidhur me faktin se kontrata e sigurimit nuk i përfshinë të gjitha kategoritë e dëmit, rrethanë kjo e cila sipas palës paditëse e vërteton faktin se nuk ka ekzistuar qëndrimi pasiv i paditësit për realizimin e kërkesës. Gjykata në përgjigje lidhur me këtë pretendim sjellë në vëmendje faktin se me lëshimin e afatit prej 5 vitesh nga dita e shkaktimit të dëmit, i cili është afat i natyrës objektive, për Gjykatën është irelevant momenti se kur paditësi ka mësuar për dëmin apo shkaktarin e të njejtit, gjegjësisht vërtetimi i faktit nëse është ruajtur afati subjektiv prej 3 vjetësh për paraqitjen e kërkesës për kompensim. Dispozita në fjalë nuk lejon hapësirë për interpretim fleksibil.

Parashkrimi është institut juridik sipas të cilit titullari i një të drejte, pas kalimit të afatit të parashikuar me ligj, nuk mund ta realizojë atë të drejtë në rrugë gjyqësore. Dispozitat nga Ligji për Marrdhëniet e Detyrimeve krijojnë bazë të mjaftueshme për palën e cila ka pësuar dëm të çfarëdo natyre që të kërkojë kompensim nga pala të cilën e konsideron përgjegjëse për shkaktimin e tij. Të njejtat dispozita, ofrojnë garanci juridike edhe për palën për të cilën pretendohet se është shkaktare e dëmit, që me kalimin e një periudhe të caktuar kohore të gëzojë mbrojtje nga kërkesa e palës tjetër, duke u thirrur në institutin e parashkrimit të kërkesës. Mbi bazën e arsyeve të lartëcekura, vlerësimi përfundimtar i Gjykatës konsiston në faktin se pala paditëse, si pasojë e qëndrimit pasiv e ka humbur të drejtën për të kërkuar kompensimin e dëmit jo material dhe material nga pala përgjegjëse – në këtë rast e paditura e dytë. Bazuar në këtë konstatim, vendosi decidivisht si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit R.N, në raport me të paditurën e dytë N “A.T ” sh.p.k, me seli në P.

- *Vendimi lidhur me kamatën* -

Gjykata në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi lidhur me kërkesën aksesore, duke e detyruar të paditurën e parë K.S “S”, me seli në P, që shumat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë paditësit së bashku me normën e kamatës e cila vlen si për mjetet e depozituara në bankat afariste që operojnë në Republikës e Kosovës, në afat më tepër se një vit, pa destinim të caktuar, duke e llogaritur nga data e ushtrimit të padisë, dt.25.09.2012, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Një vendosje e tillë është mbështetur në dispozitën nga neni 377 të LMD-së, e cila parasheh që: "*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos kryegjësë, edhe kamatën sipas shkallës, e cila në vendin e përmbushjes paguhet në depozimet e kursimit me të parë*". Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata për këtë formë të dëmit (dëmin material), iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020, konkretisht pjesës së tretë, pikës XIV të këtij Mendimi.

- *Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës* -

Në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata vendosi lidhur me shpenzimet e procedurës, në atë mënyrë që fillimisht e detyroi të paditurën e parë, K.S "S", me seli në P, që paditësit R.N, në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguajë shumën e përgjithshme në vlerë prej 93.36 Euro. Lidhur me këtë mënyrë të vendosjes, Gjykata iu referua dispozitës nga neni 452 par.2 të LPK-së, e cila përcakton që: "Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t'ia shpërblejë tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve". Në rastin konkret, paditësi, përmes parashtrësës së dt.20.03.2024, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur kërkesë të specifikuar për kompensimin e shpenzimeve në vlerën e tërësishme prej 1,556,00 Euro. Gjykata mori në konsideratë faktin se nga tërësia e kërkesëpadisë në vlerë prej 23,580.30 Euro, pjesa e aprovuar e kërkesëpadisë në raport me të paditurën e parë konsiston në shumën prej 700.30 Euro, që nënkupton se shkalla e përgjithshme e suksesit në këtë procedurë arrin në nivelin prej 3 %. Meqenëse paditësi kërkesëpadinë e ka drejtuar ndaj dy të paditurave, rrjedh se në raport me të paditurën e parë shkalla e suksesit arrin në nivelin prej 6 %. Mbi këtë bazë, Gjykata erdhi në përfundim se paditësit, nga e paditura e parë duhet t'i kompensohen shpenzimet e kësaj procedure në shumën prej 93.36 Euro, shumë kjo proporcionale me suksesin e arritur në procedurë ($1,556.00 \times 6\% = 93.36$).

Në anën tjetër, Gjykata e detyroi paditësin R.N, që në emër të shpenzimeve të krijuara në këtë procedurë, t'ia paguajë të paditurës së dytë, N "A.T", me seli në P, shumën e përgjithshme në vlerë prej 1,019.20 Euro. Në raport me këtë pjesë të vendosjes, Gjykata iu referua dispozitës nga neni 452 par.1 të LPK-së, e cila parasheh që: "Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblejë të gjitha shpenzimet gjyqësore". Referuar epilogut të kësaj çështje, rezulton se pala paditëse, e ka humbur në tërësi kontestin gjyqësor në raport me të paditurën e dytë, andaj kjo e fundit, si palë gjyqësore ka të drejtë në shpërblimin e shpenzimeve të nevojshme për ndjekjen e kësaj çështje. Lidhur me këtë, Gjykata iu referua dispozitës nga neni 453 par.1 të LPK-së, e cila përcakton që: "Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t'i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendosë gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat". Mbi këtë bazë, vendosi ta detyrojë paditësin që t'ia paguajë të paditurës së dytë shumën e përgjithshme të shpenzimeve në vlerë prej 1,019.20 Euro, sipas kërkesës së specifikuar të kësaj të fundit në fjalë përfundimtare, duke përfshirë: shumën prej 208.00 Euro në emër të përpilimit të përgjigjes në padi, si dhe shumën prej 811.20 Euro në emër të përfaqësimit në 3 seanca gjyqësore ($270.40 \times 3 = 811.20$ Euro). Përtej kësaj shume, Gjykata vlerëson se shpenzimet në vlerë prej 446.00 Euro, dhe atë: në shumën prej 208.00 Euro në emër të përpilimit të ankesës, shumën prej 30.00 Euro në emër të taksës për ankesë si dhe shumën prej 208.00 Euro në emër të përgjigjes në ankesë, në fazën në të cilën janë krijuar rezuloni që nuk janë shkaktuar me fajin e palës paditëse, andaj nuk mund t'i atribuohen të njejtit. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve, Gjykata iu referua Rregullores për Tarifat e Avokatëve, specifikisht numrave tariforë 6 dhe 7, duke marrë në referencë edhe vlerën e këtij kontesti.

Bazuar në të lartëcekurat, në mbështetje të dispozitës së nenit 160 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -
C.nr.1015/22, datë 28.03.2024

G j y q t a r i,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 176 të LPK-së, palët e pakënaqura kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.